



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Predato Received / Delivery | 25.10.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shfaqja Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM/MS/11 | 6430/2022 | | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A nr.742/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Kocanëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 742/2022 të datës 29.08.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ me avokat _____ me adrese banimi rruga _____ në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ne çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.10.2022, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër me numër A.nr.742/2022 e datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesja _____.

A r s y e t i m

Në bazë të akt Emërimit, me numër protokolli 2092, të 13.06.2022, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se ankuesja _____ mbanë pozitën "*Zyrtare e Lartë për Organizata Ndërkombëtarë*", në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 08.02.2022, me numër protokolli 349, ka shpallur shpalljen e shprehjes së interesit, për pozitën konsull të përgjithshëm, në të cilin shpallje ka aplikuar edhe ankuesja, për mes e- malit të datës 11.02.2022, duke aplikuar në tri

vende: Konsulle e Përgjithshëm në Hamburg, Ministër Këshilltar në Vjenë dhe Ministër Këshilltar në Londër.

Kolegji, konstaton se nga shkresat e lëndës del se Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 16.02.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 440, për Themelimin e Komisionit për Rotacion, ndërsa Komisioni për rotacion, me datë 25.02.2022, ka përgatitur raportin, përmes të cilit konstaton se ankuesja i plotëson kriteret specifike, kredenciale, përvojën në diplomaci e misionet konsullore e bëjnë të përshtatshme për pozitën, mirëpo deri tani nuk ka akt përmes të cilit ka përfunduar ky proces administrativ.

Ankuesja me datë 29.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me kërkesën e datës 08.07.2022 për nxjerrjen e vendimit për emërim në pozitën Konsulle e Përgjithshme në Hamburg, duke kërkuar që Këshillit të aprovojë ankesën e saj dhe të obligojë Ministren e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të nxjerr akt administrativ që të bëjë emërimin e saj në pozitën Konsulle e Përgjithshme në Hamburg/Gjermani.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa me datë 09.09.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 742/2022, e datës 29.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 22.08.2022; Shprehje e interesit e datës 08.02.2022; e- maili i datës 11.02.2022; Vendimi i datës 06.07.2022, me numër protokollit 2499; Kërkesë e datës 08.07.2022, Vendimi i datës 16.02.2022, me numër protokollit 440, për Themelimin e Komisionit për rrotacion; Kërkesën e datës 30.06.2022, me numër protokollit 2390, për qasje në dokumente zyrtare; Vendimi i datës 06.07.2022, me numër protokollit 2499, i Z.v Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Raporti i Komisionit për Rotacion; Përgjigje në ankesë e datës 09.09.2022, me numër protokollit 3583/2022; Kërkesën për tërheqje e datës 24.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankueses, *sepse:*

Ankuesja ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar kundër heshtjes administrative të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me kërkesën e datës 08.07.2022 për nxjerrjen e vendimit për emërim në pozitën Konsulle e Përgjithshme në Hamburg, duke kërkuar që Këshillit të aprovojë ankesën e saj dhe të obligojë Ministren e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të

nxjerr akt administrativ që të bëjë emërimin e saj në pozitën Konsulle e Përgjithshme në Hamburg/Gjermani.

Mirëpo ankuesja më datë 24.10.2022 ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke theksuar: *"me anë të kësaj shkresë, për arsye persona dua të tërheq lëndën time me Nr. 742/2022"*.

Bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesja përmes kërkesës së datës 24.10.2022 ka tërhequr ankesën e datës 29.08.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.742 /2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.

